| DE | SQ |
| --- | --- |
| **Weitere Maßnahmen gegen das Corona-Virus**<br>Die Landesregierung hat am 22.03.2020 ein weitreichendes Kontaktverbot für Nordrhein-Westfalen per Rechtsverordnung erlassen. Dies gilt ab sofort für den Zeitraum bis zum 19. April [aktualisiert am 23.03.2020]:<br><br>**Weitreichendes Kontaktverbot**<br><br>• Zusammenkünfte und Ansammlungen von mehr als zwei Personen sind in der Öffentlichkeit untersagt.<br>• Ausgenommen: Verwandte in gerader Linie, Ehegatten, Lebenspartnerinnen und Lebenspartner sowie in häuslicher Gemeinschaft lebende Personen<br>• Erlaubt sind die Begleitung minderjähriger und unterstützungsbedürftiger Personen<br>• Erlaubt sind zwingend notwendige Zusammenkünfte aus geschäftlichen, beruflichen und dienstlichen sowie aus prüfungs- und betreuungsrelevanten Gründen.<br>• Die Nutzung des Öffentlichen Personennahverkehrs bleibt zulässig<br><br>**Strafen bei Nichteinhaltung des Kontaktverbots**<br><br>• die zuständigen Behörden (Ordnungsamt, Polizei) sind angehalten, die Bestimmungen konsequent und, wo nötig, mit Zwangsmitteln durchzusetzen.<br>• Verstöße werden mit einer Geldbuße von mindestens 200 Euro bis hin zu 25.000 Euro und als Straftaten mit Freiheitsstrafe bis zu fünf Jahren verfolgt.<br><br>**Weitere Restriktionen:**<br><br>**Friseure, Nagelstudios, Tätowierer, Massagesalons** | **Masat tjera kundër koronavirusit**<br>Qeveria e Landit ka lëshuar një urdhëresë lidhur me ndalimin e gjerë të kontakteve për Landin Nordrhein-Westfalen më 22.03.2020. Kjo vlen menjëherë për hapësirën kohore deri më 19 prill [aktualizuar më 23.03.2020]:<br><br>**Ndalesa e gjerë e kontakteve**<br><br>• Takimet dhe tubimet prej më shumë se dy personave janë të ndaluar në publik.<br>• Përjashtim: Familjarët e linies së drejtë, bashkëshortët, partnerët bashkëjetues si dhe personat që jetojnë në një bashkësi.<br>• Shoqërimi i personave të mitur dhe që kanë nevojë është i lejuar.<br>• Takimet e detyruara për shkaqe biznesore, profesionale dhe shërbyese si dhe për arsye të provimeve ose përkujdesjeve të rëndësishme janë të lejuara.<br>• Shfrytëzimi i qarkullimit në trafik me mjete publike është i lejuar.<br><br>**Dënimet në rast të moszbatimit të ndalimit të kontaktit**<br><br>• Zyret përgjegjëse (enti për rregull, policia) janë të detyruara të zbatojnë këto rregulla në mënyrë konsekuente, nëse është nevoja, edhe me mjete të detyruara.<br>• Kundërvajtjet dënohen me një shumë prej së paku 200 euro deri më 25 000 euro dhe veprimet kundërligjore me heqje lirie deri në 5 vite.<br><br>**Restrikcionet tjera:**<br><br>**Frizerët, studiot e thonjëve, artistët e tatuazhës, sallonët për masazh** |

| | |
|---|---|
| • Dienstleistungen, bei denen ein Mindestabstand von 1,5 Metern von Mensch zu Mensch nicht eingehalten werden kann (insbesondere von Friseuren, Nagelstudios, Tätowierern, Massagesalons), sind untersagt. | • Shërbimet për qytetarë,, tek të cilat distanca prej 1,5 metra nga një person tek tjetri nuk mund të mbahet (në veçanti tek frizerët, studiot e thonjëve, artistët e tatuazhës, sallonët për masazh) janë të ndaluara. |
| **Handwerk und Dienstleistungsgewerbe** | **Zejet dhe shërbimet për qytetarë** |
| • Handwerker und Dienstleister können ihrer Tätigkeit mit Vorkehrungen zum Schutz vor Infektionen weiterhin nachgehen.<br>• Augenoptikern, Hörgeräteakustikern, orthopädischen Schuhmachern und anderen Handwerkern ist der Verkauf von nicht mit handwerklichen Leistungen verbundenen Waren untersagt; ausgenommen ist notwendiges Zubehör. | • Zejtarët dhe shërbyesit për qytetarë mund t´i kryejnë veprimtaritë e tyre, nëse i marrin masat për mbrojtje nga infekcionet.<br>• Mjeshtërve të syzeve, mjeshtërve të aparateve të dëgjimit, kupucëtarëve ortopedik dhe zejtarëve të tjerë ju është ndaluar shitja e produkteve, që nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me punë dore; përjashtohen pjesët plotësuese të nevojshme. |
| **Bau- und Gartenbaumärkte** | **Tregjet e ndërtimtarisë dhe të kopshtarisë** |
| • Der Betrieb von Bau- und Gartenbaumärkten bleibt zur Versorgung von Gewerbetreibenden und Handwerkern zulässig.<br>• Anderen Personen darf der Zutritt nur gestattet werden, wenn zum Schutz vor Infektionen geeignete Vorkehrungen getroffen sind (insbesondere Maßnahmen zur Sicherstellung von Mindestabständen und Schutzvorrichtungen für das Kassenpersonal),<br>• Unter den o.g. Voraussetzungen dürfen auch Floristen ihren Betrieb fortsetzen. | • Veprimtaria e tregjeve të ndërtimtarisë dhe të kopshtarisë për të shërbyer zejtarët dhe ndërmarrjet është e lejuar.<br>• Personave tjerë mund t´u lejohet hyrja, vetëm nëse mirren masat tjera për mbrojtjen nga infekcionet (veçanërisht masat për sigurimin e distancës dhe masave tjera mbrojtëse për personelin në kacë).<br>• Nën këto kushte guxojnë të punojnë edhe kopshtarët. |
| **Arztpraxen** | **Qendrat mjekësore** |
| • Arztpraxen und Zahnarztpraxen bleiben geöffnet. Es wird angeraten, alle Untersuchungen, die nicht zeitkritisch sind, zu verschieben.<br>• Therapeutische Berufsausübungen, insbesondere von Physio- und Ergotherapeuten, bleiben gestattet, soweit die medizinische Notwendigkeit der Behandlung durch | • Qendrat mjekësore dhe dentiste janë të hapura. Rekomandohet, që të gjitha kontrollat të shtyhen, që nuk janë kritike.<br>• Ushtrimet profesionale terapike, veçanërisht fizioterapitë dhe ergoterapitë, janë të lejuara, nëse është dëshmuar nevoja e terapisë përmes një |

| | |
|---|---|
| ärztliches Attest nachgewiesen wird und strenge Schutzmaßnahmen vor Infektionen getroffen werden.<br><br>**Krankenhäuser und Pflegeheime**<br>• Besuche sind grundsätzlich untersagt, wenn sie nicht der medizinischen oder pflegerischen Versorgung dienen oder aus Rechtsgründen erforderlich sind.<br>• Ausnahmen: unter strengen Schutzmaßnahmen, wenn es medizinisch oder ethisch-sozial geboten ist (z.B. auf Geburts- und Kinderstationen sowie bei Palliativpatienten),<br><br>**Gastronomie**<br>• Der Betrieb von Restaurants, Gaststätten, Imbissen, Mensen, Kantinen (außer Betriebskantinen) und anderen gastronomischen Einrichtungen ist untersagt.<br>• Die Belieferung mit Speisen und Getränken sowie der Außer-Haus-Verkauf ist zulässig, wenn die zum Schutz vor Infektionen erforderlichen Abstände eingehalten werden. Der Verzehr ist in einem Umkreis von 50 Metern um die gastronomische Einrichtung untersagt.<br>• Nicht öffentlich zugängliche Betriebskantinen dürfen zur Versorgung der Beschäftigten unter strengen Auflagen betrieben werden.<br><br>**Bibliotheken**<br>• Bibliotheken einschließlich Bibliotheken an Hochschulen haben den Zugang zu ihren Angeboten zu beschränken und nur unter strengen Schutzauflagen zu gestatten.<br><br>**Versammlungen, Gottesdienste, Beerdigungen**<br>• Veranstaltungen und Versammlungen sind untersagt.<br>• ausgenommen sind Veranstaltungen, die der Aufrechterhaltung der öffentlichen Sicherheit und Ordnung oder der Daseinsfür- und -vorsorge (insbesondere Blutspendetermine) dienen. | vërtetimi mjekësor dhe terapia mund të kryhet nën masat rigoroze të mbrojtjes nga infekcionet.<br><br>**Spitalet dhe shtëpitë e pleqëve**<br>• Vizitat janë në përgjithësi të ndaluara, nëse ato nuk i shërbejnë përkujdesjes mjekësore ose nuk janë të nevojshme nga arsyet juridike.<br>• Përjashtimet: nën masat rigoroze të mbrojtjes, nëse është e nevojshme në aspektin mjekësor ose etik-social (p.sh. në stacionet e lindjes dhe të fëmijëve si dhe tek pacientët paliativ),<br><br>**Gastronomi**<br>• Veprimtaritë e restoranteve, rostiçerive (çebaptoreve, fastfood), menzave, kantinave (jo kantinave të fabrikave) dhe institucioneve tjera gastronomike janë të ndaluara.<br>• Shpërndarja e ushqimeve dhe pijeve si dhe shitja jashtë objektit është e lejuar, nëse mbahet distanca për mbrojtjen nga infekcionet. Konsumimi i ushqimit në një rreth prej 50 metrash nga institucioni gastronomik është i ndaluar.<br>• Kantinat e fabrikave, që nuk janë të hapura për publik, por shërbejnë për të punësuarit, mund të veprojnë, nëse i plotësojnë kushtet rigoroze.<br><br>**Bibliotekat**<br>• Bibliotekat, përfshirë edhe bibliotekat univerziteteve, duhet të kufizojnë hyrjen në to dhe mund të lejojnë hyrjen vetëm nën plotësimin e masave rigoroze.<br><br>**Tubimet, shërbimet fetare, varrimet**<br>• Aktivitetet dhe tubimet janë të ndaluara.<br>• Përjashtohen aktivitetet,që i shërbejnë ruajtjes së sigurisë dhe rregullit publik dhe përkujdesjes (veçanërisht termineve të dhënies së gjakut). |

| | |
|---|---|
| • Versammlungen auch zur Religionsausübung, also Gottesdienste, unterbleiben.<br>• Beerdigungen sind im engsten Familienkreis und unter strengen Auflagen gestattet.<br><br>*Bleiben Sie Zuhause. Beachten Sie Hygiene- und Schutzmaßnahmen. Vermeiden Sie unnötige Sozialkontakte.* | • Tubimet edhe në ushtrimet e religjionit, pra shërbimet fetare, janë të ndaluara.<br>• Varrimet janë të lejuara vetëm në rrethin e ngushtë familjar dhe nën masa rigoroze.<br><br>Rrini në shtëpi. Përmbajuni masave higjenike dhe mbrojtëse. Mënjanoni kontaktet e panevojshme sociale. |